



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLIA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-1826
Nr. i faqëve Br. stranica No. pages	3
Data: Datum: Date:	12/03/2025
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Shëndetësisë**  
**Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health**  
**Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister**

**Nr/16/III/2025**  
**Datë:11/03/2025**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145(pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), nenin 11 paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 9 paragrafi 1.13 të Ligjit Nr. 04/L-125 për shëndetësi dhe në zbatim të Planit Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030, në zbatim të Vendimit me nr protokollit 05-9996 të datës 20.12.2024, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Emërohet Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK), në përbërje me anëtarët si në vijim:

1.1.	Naim Bardiqi,	MSh	kryesues
1.2.	Agron Aliu,	MSh	zëvendës kryesues
1.3.	Elvir Azizi,	ShSKUK	anëtar
1.4.	Ardita Baraku,	IKSHPK	anëtar
1.5.	Amir Keka,	FSSh;	anëtar
1.6.	Mirlinda Lushtaku,	ZKM	anëtar
1.7.	Muhamed Cuni,	MAPL	anëtar
1.8.	Kadrije Aliu,	ARC	anëtar
1.9.	Selim Lulaj,	AShI	anëtar
1.10.	Ylli Shala,	ASK	anëtar
1.11.	Nehat Pllana,	AIP	anëtar
1.12.	Arbesa Hoxha,	ASiguri Kibernetike	anëtar
1.13.	Afërdita Hoxha,	MSh	anëtar
1.14.	Niman Bardhi,	MSh	anëtar
1.15.	Egzon Azemi	K- MSh	anëtar

2. Komiteti Drejtues për Shëndetin Digjital të Kosovës (KDSHDK) ka rol këshillues dhe ofron monitorim të vazhdueshëm, drejtim strategjik dhe koordinim të veprimeve për të krijuar një ekosistem të plotë kombëtar të sistemit të informimit shëndetësor (SISH);
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e KDSHDK-së janë të përcaktuara në Shtojcën 1 e cila është pjesë e këtij Vendimi;
4. Detyrat dhe përgjegjësitë propozohen nga Komiteti dhe miratohen nga Ministri sipas procedurave të përcaktuara nga Rregullorja e punës së Komitetit.
  - 4.1. Komiteti do të zhvillojë aktivitetet në bazë të rregullores së punës së funksionimit të tij dhe kjo rregullore do të miratohet nga vetë Komiteti.
  - 4.2. Vendimet merren sipas kuorumit të përcaktuar me rregullore.
5. Shërbimet e sekretarisë të KDSHDK-së ofrohen nga zyrtarët e Departamentit të SISH-it;
6. Komiteti mund të zgjerojë anëtarësinë për organizata ose individë të tjerë në bazë të nevojës.
7. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit;



***Vendimi i dërgohet:***

- *Zëvendësministrave të MSH,*
- *Sekretarit të Përgjithshëm MSh,*
- *Anëtarëve;*
- *Departamenti i SISH;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSH.*

## **SHTOJCA 1: DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KDSHDK-së**

- 1. Propozon hartimin, përditësimin dhe revidimin eventual të Strategjisë së Shëndetit Digjital:** KDSHDK propozon hartimin, përditësimin dhe revidimin eventual të strategjisë të shëndetit digjital dhe planin e zhvillimit të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), për drejtimin e përgjithshëm dhe qëllimet afatgjata të shëndetit digjital në Kosovë.
- 2. Drejtimi dhe Monitorimi i Zbatimit të Sistemeve të Informimit Shëndetësor:** Komiteti monitoron zbatimin dhe funksionimin e sistemeve të informimit shëndetësor në pajtim me strategjinë e përcaktuar, ofron këshilla, rekomandime për Departamentin e sistemit të informimit shëndetësor dhe për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik të SISH-it;
- 3. Propozon hartimin e Politikave për Menaxhimin e Informimit Shëndetësor:** KDSHDK do të propozojë politika që udhëheqin menaxhimin e informimit shëndetësor.
- 4. Rekomandon opsione për sigurimin e Burimeve Financiare dhe Mbështetjes:** KDSHDK rekomandon sigurimin e fondeve për zbatimin e strategjisë së shëndetit digjital, përfshirë rekomandimin për burimin e fondeve.
- 5. Zgjidhja e Çështjeve Strategjike dhe Teknike:** KDSHDK fasilton adresimin e sfidave kryesore të identifikuara nga grupi teknik gjatë zbatimit të Planit të veprimit të Planit Strategjik për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor 2024-2030, dhe brenda fushë veprimit jep rekomandime për zgjidhjen e problemeve të evidentuara.
- 6. Koordinimi me Akterët Kryesorë:** udhëzon bashkëpunimin ndërmjet hisedarëve, përfshirë Ministrinë e shëndetësisë, ofruesit e kujdesit shëndetësor, institucionet tjera qeveritare, jo-qeveritare vendore, për të siguruar koordinimin dhe mbështetjen e nismave të shëndetit digjital në pajtim standardet ndërkombëtare.
- 7. Mbikëqyrja e Ndërveprueshmërisë dhe Standardeve të të Dhënave:** KDSHDK propozon standardet për shkëmbimin e të dhënave dhe ndërveprueshmërinë e sistemeve, duke siguruar që të gjitha sistemet shëndetësore të Kosovës të funksionojnë në harmoni.
- 8. Fuqizimi i Kapaciteteve dhe Trajnimi:** KDSHDK rekomandon programe trajnimi dhe nisma për të rritur aftësitë digjitale të profesionistëve të shëndetësisë dhe të stafit teknik, për të garantuar përdorimin e duhur dhe të sigurt të teknologjive digjitale në sektorin shëndetësor.
- 9. Hulumtim dhe Vlerësim:** propozon hulumtime dhe vlerësime për të matur ndikimin dhe efektivitetin e nismave të shëndetit digjital dhe për të informuar vendimmarrjen për zhvillime të ardhshme.